



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Personel
Zyra e Prokurimit
Nr 03/ 41
Datë : 06-05-2022.

KONTRATË PROKURIMI NR 18

62500-21-10153-1-2-1/C480

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe
"KEIS (KOSOVA EX.IMP. SUPPLY PHARMACEUT)" SH.P.K. ME SELI NË PRISHTINË
ME Nr.BIZNESI: 810519621 (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

Titulli : FURNIZIM ME PAISJE LABORATORIKE PËR NEVOJAT E QKMF-SË DR."SHPËTIM ROBAJ " NË MALISHEVË

Nr1 i prokurimit	62500-21-10153-1-2-1
Nr i brendshëm	62500/21/154/121

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr."Shpëtim Robaj " në Malishevë**

Nr.	Grupi
1	Furnizim me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr."Shpëtim Robaj " në Malishevë

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë : **30 ditë** nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë: **QKMF-në Dr. " Shpëtim Robaj" Malishevë.**

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **35,300.00€ (tridhjetëepesë mijë euro)** Euro.

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: *[shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]*

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;
- (f) *[shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit]*.

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin e saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **SHQIPE** në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Shkelqim Kabashi
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05/05/2022	Data:	04.05.2022
Vula:		Vula:	

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 62500-21-10153-1-2-1/C480

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : SHQIPE .
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % e vlerës së kontratës për 60 ditë nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Programi i ekzekutimit	11	OE Furnizimin me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr.“Shpëtim Robaj ” në Malishevë duhet ta e kryej në afatë prej tridhjetë (30) ditësh që nga dita e nënshkrimit të kontratës.
Menaxhimi i Kontrates	12	Menaxhimin e kontratës do ta bëjë zyrtari i QKMF-së z.Shpejtim Paqarizi i caktuar nga ZKA i AK. Menaxheri i kontratës është përgjegjes për mbikqyrjen e ekzekutimit të Furnizimit me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr.“Shpëtim Robaj ” në Malishevë gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të furnizimit e deri në përfundim të kontratës. Menaxheri i projektit do të mbikqyrë OE gjatë tërë kohës sa zgjatë furnizimi duke filluar nga dita e parë e deri në përfundimin e kontratës përkatësisht ekzekutimin e kontrates. Qëllimi i mbikqyrjes është të kontrollojë cilësin dhe sasinë e furnizimit. AK e ruan të drejten që t'ia ndërprej kontratën me OE për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe sasinë në afatë dhe ne përputhje të plotë me specifikacionin e ofertës .
Pranimi i furnizimit	12.1	Pranimi i furnizimit me Furnizim me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr.“Shpëtim Robaj ” në Malishevë do të bëhet nga një komision i caktuar nga ZKA i AK-së.
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	13	Të gjitha i përkasin OE.

Cilësia e furnizimeve	18.2	Furnizimi me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr.“ Shpëtim Robaj ” në Malishevë duhet të jetë në cilësi dhe sasi të kërkuar nga AK dhe në përputhëshmeri të plotë në specifikacionin e ofertës. Nese furnizimi nuk kryhet në cilësi dhe sasi të kërkuar do të i kthehet OE dhe shpenzimet e bëra do të bien në llogari të OE.
Pagesa	20.1	<u>Pagesa do të bëhet në Euro.</u> Obligohet AK që pasi ta e pranon raportin e pranimit të Furnizimi me paisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr.“ Shpëtim Robaj ” në Malishevë nga zyrtari z.Shpejtim Paqarizi (menaxheri i kontratës) si dhe faturen nga OE të ia paguaj shumen sipas nenit 2 dhe 2.1 të kësaj kontrate. Pagesat OE do të i bëhen në bazë të raportit të menaxherit të kontratës ndërsa pagesa finale do të bëhet në bazë të raportit të menaxherit të Kontratës dhe raportit të një komisioni të caktuar nga ZKA i AK-së.
Dorëzimi	21.3	Vendi i dorëzimit të Furnizimit me paisje laboratorike për nevojat e QKMF - së Dr.“ Shpëtim Robaj ” në Malishevë do të jetë në QKMF Dr.“Shpetim Robaj” në Malishevë.
Obligimet e garancionit	24.1	Furnizimet me paisje laboratorike për nevojat e QKMF – së Dr. “Shpëtim Robaj ” në Malishevë kanë garancion dymbëdhjetë (12) muaj.
	24.5	Furnizimit me paisje laboratorike për nevojat e QKMF - së Dr. “Shpëtim Robaj ” në Malishevë kanë garancion dymbëdhjetë (12) muaj nga dita e pranimit nga menaxheri i kontratës dhe nga komisioni i caktuar nga ZKA i AK. Nese gjatë periudhes së garancionit paraqiten defekte ne paisjet teknologjike të cekura ne specifikacionin e ofertes OE është i obliguar që të bëjë servisimin e tyre e nese nuk mund të i bej funksionale me servisim atëher paisjet që kanë defekt do të zëvendesohen me paisje të reja.
Vonesat në ekzekutim	25	Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të e kryej furnizimin brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës

		dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	Komisioni për ndermjetesim pranë Ministris së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Furnizim me pajisje laboratorike për nevojat e QKMF-së Dr. "Shpëtim Robaj" në Malishevë

PJESA <Nr>	PËRSHKRIMI	NJËSIA MATËSE	SASIA	ÇMIMI PËR NJËSI PA TVSH €	TVSH (%)	ÇMIMI PËR NJËSI ME TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	ANALIZATOR BIOKIMIK ME ISE. - Të ketë së paku 65 vende për vendosjen e mostrave. - Së paku 55 vende për vendosje të reagjentëve. - Të ketë së paku 4 mbajtëse për vendosjen e reagjentëve. - Frigorifer për ruajtje të reagjentëve të integruar në aparaturë. - Lexues të barkodeve (Bar-code reader). - Të punoj me mikropompa pa pasur nevojë të përdor shiringa dhe tuba peristaltic. - System i hapur. - Mundësia e shtimit të mostrave pa ndërprerje.	COPË	2	12,288.14	18%	14,500.00	29,000.00

-Të ketë së paku 70 kiveta reaksioni, me vëllim të reaksionit prej 200 µL. -Sistem të pastrimit të kivetave. -Pastrimi i kivetave të reaksionit me detergjentë acidik dhe alkalik me maksimum 1.5L/h ujë të destiluar. -Të ketë së paku 8 gjatësi valore në interval prej 340 deri 690 nm. -Kapaciteti: së paku 400 teste në orë me ISE. -Test Menu: së paku 200 teste fotometrike + ISE. -Teste on board: së paku 55 + 3 ISE. -Së paku 55 reagjent on board + 1 ISE. -Së paku 70 kiveta të reaksionit optik. -Rafti i vendosjes së mostrave të ketë së paku 65 pozita për mostra, kontroll dhe kalibrator. -Metodat e matjes: End Point, Fixed Time, Kinetic. -Pesha maksimale 50 kg. -Enë universale të mostrave: Cup, Primary tubes (diam. 12 -16, height 50 - 100 mm).					
---	--	--	--	--	--

	-Vëllimi i mostrës: nga 2 deri në 100 µL. -Konsumimi i ujit në maksimum 1.5 L/h, pa pasur nevojë për dejonizator -Të jetë i pajisur me kompjuter dhe Laser printer për përpunim dhe shtypje të rezultateve.						
2.	<u>Centrifugë (Bench top centrifuge)</u> -Numri i pozicioneve për vendosje të mostrave 32 e më tepër. -Shpejtësia maksimale e rrotullimeve 6000 rpm. -Rrotullimet të jenë të programueshme. -Shfaqje digjitale të kohës dhe shpejtësisë / RCF (xg). -Të përkrah tubat deri në 15 ml. -Motor me sa më pak zhurmë. -Mbrojtje nga mbi nxehja e motorit. -Të operoj në 208 - 240 V, 50 - 60 Hz -Garancion së paku 12 muaj.	COPË	1	2,457.63	18%	2,900.00	2,900.00

3.	<u>Centrifugë (Bench top centrifuge)</u> -Kapaciteti maksimal : 12x15 ml. -Shpejtësia maksimale : 5.000 rpm. -RCF maksimale : 2.822xg. -Sistem kontrolli me mikroprocesor të programueshëm. -Shfaqje digjitale të kohës dhe shpejtësisë / RCF (xg). -Të ketë adaptor për tuba prej 1,5/2 ml, 5 ml dhe 7 ml. -Motor me sa më pak zhurmë. -Mbrojtje nga mbi nxehja e motorit. -Të operoj në 208 - 240 V, 50 - 60 Hz. -Garancion së paku 12 muaj.	COPE	2	720.34	18%	850.00	1,700.00
4.	<u>UPS Bateri</u> -UPS Bateria të ketë fuqi mbi 3000VA / 2700W . -Tower Type. -Plugs: minimum 2 -Të operoj në 208 - 240 V, frekuncë 50 / 60 Hz Auto detection. -Garancion së paku 12 muaj.	COPE	2	720.34	18%	850.00	1,700.00
TOTALI ME TVSH							35,300.00

	TOTALI PA TVSH	29,915.25
	TVSH 18%	5,384.75